



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS

NJOFTIM PËR SHTYP

Rasti: Përftimi i kontrollit të Bankës Ndërkombëtare Tregtare SHA nga Union Bank SHA.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar shkresa me Nr. 641 Prot., datë 12.11.2018, protokoll i AK, “Union Bank SHA blen aksionet e Bankës Ndërkombëtare Tregtare SHA” ku jemi njoftuar në lidhje me transaksionin e blerjes së aksioneve të Bankës Ndërkombëtare Tregtare SHA nga Union Bank SHA.

Referuar dokumentit “Marrëveshja për shitje dhe blerje aksionesh në Bankën Ndërkombëtare Tregtare SHA” palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse:

Union Bank SHA, një institucion financiar e licencuar në 20.02.1997 për kryerjen e transfertave, kredihënie dhe aktivitet depozitues si dhe aktivitete të tjera sipas Ligjit Nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, Ligjit Nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë” si dhe në përputhje me rregulloret e aprovuara nga Këshilli Mbikqyrës i Bankës së Shqipërisë.

Pala shitëse:

-ICB Financial Group Holdings AG është shoqëri e themeluar sipas legjislacionit Zvicerian, e cila ushtron aktivitetin e saj si shoqëri investimesh për disa shoqëri tregtare dhe shoqëri financiare që operojnë kryesisht në Afrikë, Azi dhe në Evropë, përkatësisht nëpërmjet Bankës Ndërkombëtare Tregtare në Shqipëri, International Commercial Bank LTD në Tanzani dhe International Commercial Bank LTD në Bangladesh.

Target

-Banka Ndërkombëtare Tregtare SHA është një shoqëri shqiptare, e licencuar në 20.02.1997 për kryerjen e transfertave, kredihënie dhe aktivitet depozitues si dhe aktivitete të tjera sipas Ligjit Nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, Ligjit Nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë” si dhe në përputhje me rregulloret e aprovuara nga Këshilli Mbikqyrës i Bankës së Shqipërisë.

Përqendrimi i njoftuar konsiston në përftimin e kontrollit të drejtëpërdrejtë nga Union Bank SHA të Bankës Tregtare Ndërkombëtare SHA.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Si pasojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.